



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:242593

Datë: 18.10.2023

Numri i dokumentit: 04800718

C.nr. 600/16

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtar Argzon Muçaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.D. nga fshati Ll., Komuna B., i përfaqësuar me autorizim nga V.I. avokat nga Gjilani, kundër të paditurit KGJK në P., i përfaqësuar me autorizim nga B.M., lidhur me çështjen e kompensimit të dëmit për shkak të privimit të pa drejtë nga liria, vlera e kontestit 158.066.19-€, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor publik të mbajtur me datë 04.10.2023, ndërsa me datë 18.10.2023, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET PJESËRISHT SI E BAZUAR kërkesëpadia e paditësit A.D. nga fshati Ll., Komuna B.

I. DETYROHET i padituri KGJK. me seli në P. në emër të kompensimit të dëmit jo material dhe material të shkaktuar si pasojë e privimit të pa drejtë nga liria, për kohën e kaluar në paraburgim në kohëzgjatje prej 1370 (një mijë e treqind e shtatëdhjetë) ditë, nga data 30.06.2010 deri me datën 31.03.2014, paditësit t’ia paguajë shumat si në vijim:

1. Në emër të dëmit jo material

a) Në emër të cenimit të autoritetit, nderit, të lirisë, të drejtave të personalitetit dhe frikës së përjetuar, shumën prej.....54.800.000-€.

2. Në emër të dëmit material

a) Në emër të fitimit të humbur për periudhën 30.06.2010 deri me 31.03.2014 shumën prej.....10.559.11-€.

b) Në emër të shpenzimeve për pakot ushqimore shumën prej.....1.280.00-€.

II. DETYROHET e paditura që paditësit, shumat e gjykuara si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, t’ia paguajë me kamatë ligjore prej 8%, për dëmin jo material do të rrjedh nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit me datë 18.10.2023, kurse për dëmin material nga dita e parashtrimit të padisë 17.03.2016, e deri në pagesën e tërësishme, si dhe shpenzimet e procedurës në lartësi prej 2332.40-€, e të gjitha në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

III. REFUZOHET SI E PABAZUAR pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit, përtej shumave të gjykuara në pikën I të dispozitivit, për kompensimin e dëmit jo material në emër të cenimit të autoritetit, nderit, të lirisë, të drejtave të personalitetit dhe frikës së përjetuar në shumën prej 85.200.00-€.

A r s y e t i m

Paditësi A.D. nga fshati Ll., Komuna B., i përfaqësuar me autorizim nga V.I. avokat nga Gjilani, në këtë gjykatë me datë 16.03.2016 ka paraqitur padi duke kërkuar shpërblimin e dëmit jo material dhe material, si pasojë e privimit të pa drejtë nga liria në kohëzgjatje prej 1370 (një mijë e treqind e shtatëdhjetë) ditë.

I autorizuari i paditësit përmes padisë, gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se mbesim në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë së saj. Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 18.09.2023 e ka precizuar kërkesë padinë duke kërkuar për dëmin jo material për ditët e qëndrimit në paraburgim pa bazë ligjore për periudhën 30.06.2010 deri me datën 31.03.2014 prej 1370 ditë në paraburgim pa arsye në shumën prej 105.000.00-€, që për një ditë i bie 76.64-€, për dëmin material në emër të fitimit të humbur për ditët e humbura 30.06.2010 deri me 31.03.2014 ka kërkuar shumën prej 10.559.11-€, në bazë të plotësimit të ekspertizës të datës 04.08.2023 duke llogaritur edhe kamatën ligjore sipas ekspertizës gjerë me datën 31.07.2023 shumën prej 6.227.08-€, që totali është 16.786.19-€, për dëmin material në emër të pakove ushqimore ka kërkuar shumën prej 1.280.00-€, në emër të frikës së përjetuar shumën prej 15.000.00-€, në emër të shkeljes së nderit, moralit dhe autoritetit, prestigjit të tij në shumën prej 20.000.00-€, çka totali i tërë kërkesëpadisë në përshkrimin si më lartë arrin shumën totale prej 158.066.19-€. Të gjitha këto i ka kërkuar me kamatë ligjore prej 8 % sipas LMD-së nga data e ushtrimit të padisë në gjykatë e deri në pagesën definitive. Në fjalën përfundimtare ka shtuar se baza juridike e kërkesëpadisë është vërtetuar me aktgjykimin e plotfuqishëm të gjykatës Themelore në Prishtinë PKR nr.585/2014 të datës 30.03.2015, ndërsa lartësia e kërkesëpadisë është vërtetuar me ekspertizën e psikiatrisë të datës 17.11.2021 duke i propozuar gjykatës që e njëjta kërkesëpadi të aprovohet në tërësi si e bazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar, dhe atë për padi 325.00-€, për gjashtë seanca gjyqësore nga 422.50-€ për seancë gjithsejtë 2.535.00-€, për ekspertizë financiare dhe ekspertizë psikiatrike shumën prej 352.00-€ si dhe në emër të taksës gjyqësore shumën prej 150.00 euro, gjithsejtë në shumën 3363.00-€.

Përfaqësuesi i palës së paditur, në seancat e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nuk e kundërshton bazën e kërkesëpadisë të paditësit për kompensimin të dëmit material dhe jo material për periudhën e privimit nga liria prej 1356 ditëve të qëndrimit në paraburgim. Por e paditura e kundërshton lartësinë e kompensimit i cili kompensimin të bëhet konform UA me nr. 01/2023 për kompensimin e dëmit të personat e dënuar ose të arrestuar pa arsye respektivisht nga 25,00-€ në ditë, ndërsa, pjesën tjetër të kësaj shume e kundërshtojmë në tërësi. Po ashtu në rastin e vendosjes të ja falë besimin pjesërisht ekspertizës së psikiatrisë të punuar nga Dr. N.M. ekspertiza e datës 17.11.2021. Ne si palë e paditur që nga fillimi nuk ka qenë kontestuse se paditësi për gjatë kohës sa ka qenë i provuar nga liria ka pasur dhimbje shpirtërore, për ne nga fillimi ka qenë kontestuse mënyra e përcaktimi të dhimbjeve shpirtërore dhe kohëzgjatja e këtyre dhimbjeve, inteziteti i lartë prej 6 muajve, intensiteti mesatar deri sa ka përfunduar procedura penale dhe intenziteti i ulët që edhe tani është prezentë. Andaj, edhe gjatë pyetjeve të bëra në seancë ekspertes përgjigjet e saj kanë qenë subjektive meqenëse nuk ka ndonjë instrument që përcakton kohëzgjatjen e dhimbjeve por ka qenë vlerësim subjektiv. Po ashtu, i propozojmë gjykatës që me rastin e vendosjes të ja falë pjesërisht besimin. Po ashtu, me rastin e vendosjes gjykata të ja falë besimin plotësimit të ekspertizës financiare për dëmin material në shumën prej 10,559.11-€. Gjithashtu, për shpenzimet në emër të vizitave familjare ti njihet shuma prej 2275-€ konform ofertës të bërë nga Komisioni për Kompensimin e Dëmit të Personave të Privuar pa Arsyeje nga Liria e datës 29.09.2015. Pjesën tjetër të kërkesë padisë

përtej këtyre shumave e kundërshtojmë në tërësi dhe gjykatës i propozojmë që e njëjta të refuzohet si e pa bazuar.

Për shpenzimet e procedurës ka shtuar që të njëjtat të njihen në bazë të suksesit në procedurë.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, sipas propozimit të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, në seancën e shqyrtimit kryesor ka zhvilluar procedurën e të provuarit dhe ka administruar provat: Aktvendimi i datës 02.07.2010 me nr. GjPP nr.135/2010 i lëshuar nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë, Aktakuza e Prokurorisë Publike të Qarkut me numër PPR.nr.140-2 (400-1)/10 e datës 21.02.2011, Aktgjykim i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Krimeve të Rënda me numër P.NR. 134/11 dhe PKR nr. 44/11 i datës 31.03.2014, Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Krimeve të Rënda me numër P.NR 134/11 dhe PKR nr. 44/11 i datës 31.03.2014, Ankesa e drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë i datës 30.06.2014, Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës me numër PAKR nr. 360/14 i datës 26.09.2014, Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Krimeve të Rënda me numër PKR nr. 585/14 dt.30.03.2015, Kërkesa e Drejtuar KGJK-së përkatësisht Komisionit për Kompensimin e dëmit Personave të Dënuar pa Arsyeje dhe Personave për heqjen e lirisë pa bazë e datës 12.06.2015, Oferta për ujdj barazim jashtë gjyqësore e lëshuar nga Komisioni për e kompensimin e dëmit personave të dënuar pa arsye dhe personave për heqjen e lirisë pa bazë e datës 28.09.2015, Pëlqimi për tërheqja e padisë me numër C.nr 600/16 e lëshuar nga Avokatura Shtetërore e Kosovës ndaj të paditurës Qeveria e Kosovës, Mendimi i ekspertës së psikiatrisë Dr. Sc. N.M. i datës 17.11.2021, Kontrata e punës e lëshuar me datë 01.05.2009 nga LP "P." M.I. në cilësi të punëdhënësit, Vërtetimi i lëshuar nga LH "P." i datës 01.09.2021, Fletëpagesat e lëshuara nga P.C. Bank të datës 27.07.2011, 03.05.2011, 11.07.2011, 05.08.2021, 10.05.2011, 18.02.2012, 14.04.2011, 07.02.2011, 15.08.2011, 04.04.2011, 28.12.2021, 16.06.2011, 16.11.2011, 01.09.2011, 27.10.2011, 12.09.2011, 12.10.2021, 06.03.2012, 06.06.2012, 20.12.2011, 09.12.2011, 03.02.2011, 16.12.2010, 19.07.2011, 13.04.2011, 04.11.2010, 06.01.2011, 26.08.2010, 10.08.2010, 22.03.2011, 26.01.2011, 04.10.2010, 02.12.2010, 18.10.2010, 07.02.2012, 10.02.2011, 22.05.2012, 07.05.2012, 24.01.2012, 20.03.2012, 03.04.2012, 13.04.2012, 20.02.2012, 28.06.2012, 29.07.2010, 01.01.2011, fletëpagesat e lëshuara nga R. Bank me datë 13.09.2010, 12.07.2010 dhe fletëpagesa e datës 12.07.2010, ekspertiza financiare e datës 31.03.2021 e ekspertit financiar A.B. dhe plotësim ekspertiza financiare e datës 04.08.2023 e ekspertit financiar A.B.

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në nenin 8 të LPK-së, e aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata konstatoj se në mes të palëve nuk ishte kontestuese fakti se paditësi është privuar nga liria pa të drejtë duke qëndruar në paraburgim nga data 30.06.2010 deri me datën 31.03.2014, ku gjatë kësaj kohe paditësi përveç që i është mohuar liria, të njëjtit i janë shkaktuar edhe dhimbje shpirtërore, po ashtu, nuk ishte kontestuese baza e kërkesëpadisë, sepse e njëjta është pohuar nga i padituri në seancat gjyqësore. Bazuar në paragrafin 2 të nenit 321 të LPK-së i cili parasheh se: *"Nuk ka nevojë të provohen faktet të cilat pala i ka pohuar para gjykatës gjatë procesit gjyqësor"*, gjykata bazën e kërkesëpadisë e konsideroj si të provuar, kurse në vijim e trajtoj vetëm aspektin e lartësisë, sepse kontestuese në mes të palëve ndërgjyqëse ishte lartësia e kërkesës në raport me dëmin jo material dhe material.

Përmes Aktvendimit të datës 02.07.2010 GjPP nr.135/2010 i lëshuar nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë, gjykata konstatoj se paditësit i është caktuar paraburgimi me datë 30.06.2010 deri me datë 30.07.2010. Kurse, nga Aktakuza e Prokurorisë Publike të Qarkut me numër PPR.nr.140-2 (400-1)/10 e datës 21.02.2011, gjykata konstatoj se paditësi ishte i akuzuar për veprën penale në bashkëkryerje vjedhje e rëndë grabitqare nga neni 256 paragraf 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së.

Nga Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Krimeve të Rënda me numër P.NR 134/11 dhe PKR nr. 44/11 i datës 31.03.2014, gjykata konstatoj se paditësit i është ndërprerë masa e paraburgimit me datë 31.03.2014. Ndërsa, nga Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Krimeve të Rënda me numër PKR nr. 585/14 i datës 30.03.2015, gjykata konstatoj se paditësi është liruar nga akuza për shkak të tërheqjes së prokurorit të shtetit nga ndjekja penale, me çka edhe ka përfunduar procedura penale ndaj tij.

Nga vendimet e lartcekura, gjykata konstatoj se paditësi ka qëndruar në paraburgim nga data 30.06.2010 deri me datën 31.03.2014, dhe nga kalkulimi i ditëve të kaluara në paraburgim në këtë periudhë del të jetë 1370 ditë.

Nga Kërkesa e Drejtuar KGJK-së përkatësisht Komisionit për Kompensimin e Dëmit Personave të Dënuar pa Arsye dhe Personave për heqjen e lirisë pa bazë e datës 12.06.2015, gjykata konstatoj se paditësi i është drejtuar të paditurit për kompensimin e dëmit material dhe jo material si pasojë e privimit të pa drejtë nga liria. Ndërsa, bazuar në këtë kërkesë, Komisioni i lartcekur i ka ofruar paditësit ujdi apo barazim jashtë gjyqësor me datë 28.09.2015, duke i ofruar paditësit në emër të kompensimit të dëmit material për fitimin e humbur shumë prej 8.190.00-€, në emër të kompensimit të dëmit jo material shumë prej 8.190.00-€, në emër të përpilimit të kërkesës për kompensim dhe të përfaqësimit nga ana e avokatit shumë prej 120.00-€, në emër të shpenzimeve të vizitave familjare dhe pakove shumë prej 2.275.00-€, në shumë të përgjithshme prej 18.775.00-€, e cila ofertë është refuzuar nga paditësi.

Për të vërtetuar intensitetin e dhimbjeve shpirtërore, shqetësimeve dhe frikës që mund të ketë pësuar paditësi, si pasojë e qëndrimit në paraburgim, gjykata sipas propozimit të autorizuarit të paditësit ka nxjerrë provën me ekspertizë nga lëmi i psikiatrisë, e punuar nga Dr. Sc. N.M. psikiatër e datës 17.11.2021. Ekspertja e psikiatrisë ka konstatuar se në periudhën e mbajtjes në paraburgim, dhe atë nga data 30.06.2010 gjer më datë 31.03.2014, ka përjetuar vuajtje dhe dhimbje shpirtërore të intensitetit të lartë që kanë zgjatur rreth 6 muaj, sidomos në rastin kur e kanë arrestuar dhe është paraburgos, ka qenë periudhë shumë e rëndë e përvojës streso gjene kur është privuar nga drejta prindërore, ngase ka qenë prind i dy fëmijëve djem, njëri foshnje 4 muajshe, ndërsa tjetri 2 vjeçar. Kjo gjendje e paditësit, është shoqëruar me dëmtim të integritetit dhe personalitetit, imazhit personal duke e afektuar në aspektin psiko emocional e që më tej në paraburgim është manifestuar me dhimbje shpirtërore të intensitetit të mesëm që kanë zgjatur deri në lirimin e plotë nga aktakuza me datë 31.03.2014, shoqëruar me vështirësi të më tej me të adaptimit në kushte penale dhe ballafaqimit me akuzën e rëndë që i është vënë në barrë, ndjenja e frikës dhe stresit të vazhdueshëm brengës, pa sigurisë dhe ankthit për të ardhmen e tij, pasigurisë rreth procesit gjyqësor shoqëruar me rënie disponimi dhe vullneti, duke përfshirë, dëmtimin e imazhit personal dhe familjar, reflektimit negativ që ka pasur procesi gjyqësor dhe paraburgimi në raportet sociale sidomos në raport me bashkëfshatarët e tij të cilët e kanë shikuar me një sy tjetër.

Gjykata pasi që vlerësoj dhe analizoj ekspertizën e psikiatrisë, të njëjtën e ka pranuar në tërësi si të besueshme, pasi që e njëjta ishte profesionale dhe e argumentuar, po ashtu, ishte e punuar

sipas detyrave të caktuara paraprakisht nga gjykata, duke ofruar të dhëna lidhur vërtetimin e fakteve në këtë çështje kontestimore.

Nga Kontrata e punës e lëshuar me datë 01.05.2009 nga LP “P.” M.I. në cilësi të punëdhënësit dhe Vërtetimi i lëshuar nga LH “P.” i datës 01.09.2021, gjykata konstatoj se paditësi ka qenë i punësuar në këtë biznes në pozitën e menaxherit. Sipas propozimit të autorizuarit të paditësit, gjykata ka nxjerr ekspertizën financiare për të përcaktuar lartësinë e fitimit të humbur, gjatë kohës sa paditësi ka qëndruar në paraburgim, e që është privuar nga realizimi i të ardhurave nga puna e lartcekur, po ashtu, e njëjta ekspertizë është plotësuar nga i njëjti ekspert me datë 04.08.2023. Eksperti financiar, përmes plotësimit të ekspertizës ka konstatuar se gjatë periudhës së qëndrimit në paraburgim prej 30.06.2010 deri me 31.03.2014 pagat e pa realizuara të paditësit për këtë periudhë nga punëdhënësi “P.” me seli në B. arrijnë në shumën prej 10,559.11-€.

Shumën e lartcekur, eksperti e ka konstatuar përmes pagës së përcaktuar nga punëdhënësi në bazë të kontratës e cila u administrua si provë në këtë procedurë. Gjykata pasi që analizoj dhe vlerësoj ekspertizën financiare, të njëjtën e konsideroj si profesionale dhe e hartuar në përputhje me detyrat e caktuara paraprakisht nga gjykata për ekspertin.

Nga fletëpagesat e lëshuara nga P.C. Bank të datës 27.07.2011, 03.05.2011, 11.07.2011, 05.08.2021, 10.05.2011, 18.02.2012, 14.04.2011, 07.02.2011, 15.08.2011, 04.04.2011, 28.12.2021, 16.06.2011, 16.11.2011, 01.09.2011, 27.10.2011, 12.09.2011, 12.10.2021, 06.03.2012, 0.06.2012, 20.12.2011, 09.12.2011, 03.02.2011, 16.12.2010, 19.07.2011, 13.04.2011, 04.11.2010, 06.01.2011, 26.08.2010, 10.08.2010, 22.03.2011, 26.01.2011, 04.10.2010, 02.12.2010, 18.10.2010, 07.02.2012, 10.02.2011, 22.05.2012, 07.05.2012, 24.01.2012, 20.03.2012, 03.04.2012, 13.04.2012, 20.02.2012, 28.06.2012, 29.07.2010, 01.01.2011, fletëpagesat e lëshuara nga R. Bank me datë 13.09.2010, 12.07.2010 dhe fletëpagesa e datës 12.07.2010, në llogari të Qendrës së Paraburgimit në L., të kryera në emër të paditësit, gjykata konstatoj se këto pagesa janë kryer në emër të pakove ushqimore, në lartësi prej 1,280.00-€.

Rrjedhimisht, në bazë të gjendjes faktike të konstatuar si më lartë, gjykata ka vërtetuar se paditësi ka qëndruar në paraburgim nga data 30.06.2010 gjer më datë 31.03.2014, i cili paraburgim është konstatuar se ka qenë i jashtëligjshëm, për faktin se paditësi është liruar nga të gjitha akuzat, si pasojë e tërheqjes së prokurorit të shtetit nga ndjekja penale. Njëkohësisht, gjykata konstatoj se paditësit si pasojë e qëndrimit në paraburgim, përkatësisht privimit nga liria i janë shkaktuar dhimbje shpirtërore, i është cenuar autoriteti, nderi, liria, të drejtat e personalitetit, e po ashtu, ka përjetuar frikë dhe pasiguri. Po ashtu, është privuar nga e drejta për të punuar dhe realizuar të hyra gjatë kësaj periudhë kohore, për çka i është shkaktuar dëm material, e po ashtu, në cilësi të dëmit material paditësi ka shpenzuar edhe mjete të tjera monetare të dërguara në Qendrën e Paraburgimit në L. në emër të tij, përmes llogarisë bankare.

Në bazë të provave të prezantuara dhe gjendjes faktike të vërtetuar si më lartë, gjykata vlerëson se personat e privuar nga liria e gëzojnë të drejtën e kompensimit, dhe një e drejtë e tillë garantohet edhe me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përkatësisht me nenin 5 paragraf 5 të saj i cili parasheh: “Çdo person që arrestohet ose burgoset në kundërshtim me dispozitat e këtij neni ka të drejtën për të kërkuar dëmshpërblim.” Dispozitat e kësaj Konvente, bazuar në nenin 22 paragraf 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës kanë zbatim të drejtpërdrejt në rendin juridike të Republikës së Kosovës. Në interpretimin e nenit të lartcekur të Konventës, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, në rastin *SAHAKYAN v. ARMENIA* vlerëson se kjo dispozitë nuk duhet të interpretohet se ofron një të drejtë për kompensim të

natyrës thjesht monetare, po gjithashtu, duhet të ofrojë një të drejtë të tillë për çdo shqetësim, ankth dhe zhgënjim që një person mund të vuaj si rezultat i shkeljes së dispozitave nga neni 5 i saj.

Në lidhshmëri me këtë, Kodi Nr. 08/L-032 i Procedurës Penale në nenin 529 paragraf 1 nën-paragraf 1.1. parasheh: *“E drejta në kompensim dëmi i takon gjithashtu: 1.1. personit i cili është mbajtur në paraburgim e kundër tij nuk është filluar procedurë penale ose procedura është pushuar me aktvendim të formës së prerë ose ai me aktgjykim të formës së prerë është liruar nga akuza apo akuza është refuzuar.”* Në rastin konkret, paditësi është mbajtur në paraburgim, dhe përmes aktgjykimit i cili ka marr formën e prerë është refuzuar akuza, ashtu siç përcaktohet me dispozitën e lartcekur, lidhur me të drejtën e kompensimit. Kurse, paragrafi 3 i nenit 527 të Kodit të lartcekur parasheh se: *“Padia për kompensim dëmi paraqitet kundër organit publik kompetent në lëmin e çështjeve Gjyqësore.”* Në përputhje me këtë dispozitë, paditësi ka paraqitur padinë, kundër organit publik kompetent në lëmin e çështjeve gjyqësore, përkatësisht Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Me tutje, dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve përkatësisht neni 136 paragraf 1, parasheh: *“Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij.”* Në rastin konkret, gjykata vlerëson se paditësit i është shkaktuar dëm si në aspektin jo material po ashtu, edhe në atë material, me rastin e privimit nga liria, për çka e paditura ka për detyrë të kompensojë.

Ndërsa, në bazë të nenit 183 paragraf 2 të LMD-së parashihet se: *“Për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëndetit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material.”* Kurse, paragrafi 2 i të njëjtit nen përcakton se: *“Me rastin e vendosjes për kërkesën për shpërblimin e dëmit jo material, si dhe për lartësinë e shpërblimit të tij, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të së mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, por edhe për atë, se me te mos të favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror.”* Bazuar në këtë dispozitë, kompensimi për dëmin jo material duhet të jetë në përputhje me vëllimin e dhembjeve të pësuar shpirtërore, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të drejtave të personalitetit, të cilat i ka përjetuar paditësi si pasojë e privimit të kundërligjshëm nga liria.

Paditësi përmes padisë dhe precizimit të saj në seancën e shqyrtimit kryesor, ka kërkuar në emër të dëmit jo material për ditët e qëndrimit në paraburgim pa bazë ligjore për periudhën 30.06.2010 deri me datën 31.03.2014 prej 1370 ditë në paraburgim pa arsye shumë prej 105.000.00-€, që për një ditë i bie 76.64-€, në emër të frikës së përjetuar ka kërkuar shumë prej 15.000.00-€, dhe në emër të shkeljes së nderit, moralit dhe autoritetit, prestigjit të tij ka kërkuar shumë prej 20.000.00-€, në shumë e përgjithshme për dëmin jo material prej 140.000.00-€.

Mirëpo, gjykata vlerëson se bazuar në nenin 183 të lartcekur të LMD-së, paditësit i takon kompensimi për dhimbje shpirtërore për shkak të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive, të drejtave të personalitetit dhe frikës së përjetuar të cilat hyjnë në një kategori të dëmit, dhe formulimi si në kërkesëpadi dhe precizimin e saj nga pala paditëse, duke kërkuar për këtë formë të dëmit në kategori të ndryshme, në vete paraqet kërkesën për të njëjtën kategori të cilën e ka njohur dispozita e lartcekur si bazë për shpërblim të dëmit jo material.

Bazuar në këtë, gjykata kërkesën e paditësit për kompensimin e dëmit jo material, e trajtoj si kërkesë unike për kompensimin e dëmit jo material në emër të dhimbje shpirtërore për shkak të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive, të drejtave të personalitetit dhe frikës së përjetuar, për faktin se dispozita e lartcekur e LMD-së, nuk i njeh si kategori të veçanta të shpërblimit të dëmit, por të njëjtat hyjnë në kuadër të kategorive të lartcekura, për të cilat ligji njeh të drejtën e shpërblimit të dëmit jo material për dhimbje shpirtërore për shkak të shkeljes së nderit ose të lirisë të drejtave të personalitetit dhe frikës së përjetuar.

Lidhur me vendosjen e lartësisë për dëmin jo material si më lartë, gjykata mori parasysh dispozitën e nenit 183 të LMD- së dhe nenin 323 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, duke marr parasysh faktin se kompensimi i dëmit jo material konsiderohet si satisfaksion për të dëmtuarin, duke ndikuar kështu në zbutjen e pasojave negative që janë paraqitur si pasoj e dëmit në cenimin e vlerave personale të paditësit.

Për më tepër, sa i përket kompensimit të dëmit jo material, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, në rastin *Vasilevskiy dhe Bogdanov kundër Rusisë*, lidhur me kompensimin e personave të dënuar pa arsye, në vendimin e saj ka shprehur qëndrim se detyra e vlerësimit të dëmit që duhet dhënë personit si kompensim është e vështirë, veçanërisht kur kemi të bëjmë me një rast kur janë në shprehje të drejtat personale, si dhe vuajtja, çoftë fizike apo mendore, është objekt i kërkesës për kompensim. Po ashtu në këtë vendim është thënë se nuk ka ndonjë standard me të cilën dhimbjet shpirtërore, shqetësimi psikologjik dhe ankthi mund të maten në një kundërvlerë të saktësisht të matshme të parave. Më tej, kjo gjykatë ka theksuar se vlerësimi nga ana e gjykatave i shumave të matshme të kompensimit, duhet të bëhet duke u bazuar në kriteret qëndrueshme të cilat duhet të marrin parasysh standardin e jetës të vendit. Sido që të jetë, Gjykata Evropiane ka theksuar se nuk mund të lejohet një shumë tejet e ulët e kompensimit, e cila do të ishte aq e ulët saqë do të minonte frymën e vërtetë të nenit 5.5 të Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut, ngase do të humbiste thelbin e zbatueshmërisë së këtij neni, i cili garanton të drejtën e kompensimit të personave të dënuar apo paraburgosur pa arsye. Mbi bazën e të lartcekurave, gjykata konsideroj se njohja e kompensimit të dëmit për paditësin në emër të cenimit të lirive personale të tij, në kohëzgjatje prej 1370 ditë të qëndrimit në paraburgim të paditësit, si dhe pasojat të cilat i ka shkaktuar privimi i pa drejtë nga liria, duke marr për bazë moshën e re të tij, aspektin familjar duke përfshirë moshën e vogël të fëmijëve, e duke u bazuar edhe në ekspertizën e ekspertit psikiatër, vlerësoj se shumat adekuate për kompensimin e dëmit jo material është prej 40.000-€ për një ditë të qëndrimit në paraburgim, gjithsej shumat prej 54.800.000-€, në emër të dëmit jo material për dhimbje shpirtërore për shkak të shkeljes së nderit ose të lirisë të drejtave të personalitetit dhe frikës së përjetuar, duhet të vendoset si në pikën I të dispozitivit, pika a) të këtij aktgjykimi, ndaj dhe e aprovoi të bazuar kërkesën e padisë së paditësit.

Lidhur me kompensimin e dëmit material në emër të fitimit të humbur për periudhën 30.06.2010 deri me 31.03.2014, e njëjta nuk ishte kontestuese për palën e paditur, dhe e njëjta është pohuar në seancën e shqyrtimit kryesor, duke i propozuar gjykatës që të vendoset në bazë të plotësim ekspertizës financiare. Sipas nenit 321 paragraf 2 të LPK-së parashihet se: *“Nuk ka nevojë të provohen faktet të cilat pala i ka pohuar para gjykatës gjatë procesit gjyqësor.”* Andaj, bazuar në këtë dispozitë, gjykata nuk u lëshua në arsyetimin e bazës juridike lidhur me kompensimin e dëmit material mbi këtë bazë. Kurse, për lartësinë e kompensimit për këtë kategori të dëmit material gjykata e vendosi duke u bazuar plotësimin e ekspertizës së ekspertit financiar, duke i njohur shumën prej 10,559.11-€, sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Ndërsa, sa i përket kompensimit të dëmit material në emër të shpenzimeve për pakot ushqimore dhe lartësisë së tij, gjykata vendosi duke u bazuar në fletëpagesat e kryera në emër të paditësit në llogari të Qendrës

së Paraburgimit në L., e po ashtu, e njëjta nuk ishte kontestuese as për të paditurën, për çka gjykata vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit duke i njohur të drejtën e kompensimit në lartësi prej 1,280.00-€.

Kurse, lidhur me pikën III të dispozitivit të aktgjykimit, përkatësisht me pjesën e refuzimit të kompensimit në emër të dëmit jo material në emër të cenimit të autoritetit, nderit, të lirisë, të drejtave të personalitetit dhe frikës së përjetuar në shumën prej 85.200.00-€, gjykata vlerësoj se kompensimi përtej shumës së gjykuar nuk do të ishte në harmoni me të mirën e shkelur, duke marr për bazë natyrën e dhembjeve të pësuar shpirtërore, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të drejtave të personalitetit, për çka vendosi që e njëjta të refuzohet.

Vendimin mbi kamatën gjykata e bazoj në nenin 382 të LMD-së, sipas të cilit: *“1. Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. 2. Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë.”* Për dëmin jo material gjykata e njohu të drejtën në kamatë nga momenti i përpilimit të aktgjykimit me datë 18.10.2023. Kjo për faktin se pala e paditur bie në vonesë dhe është e detyruar, që përveç dëmit të paguaj edhe kamatën, nga momenti kur ka kuptuar për llojin dhe vëllimin e dëmit të shkaktuar. Ndërsa, për dëmin material, kamatën e njohu nga momenti i paraqitjes së padisë me datë 17.03.2016, duke u bazuar në propozimin e palës paditëse.

Vendimin që pala e paditur t’i bart shpenzimet e procedurës, gjykata e bazoj në dispozitat e nenit 449 dhe 452 dhe 463 të LPK-së. Ndërsa, lartësinë e shpenzimeve të procedurës gjykata e bazoj në Tarifën e Odës së Avokatëve, dhe atë për padi 208.00-€, për gjashtë seanca gjyqësore nga 270.40-€ për seancë gjithsejtë 1.622.40-€, për ekspertizë financiare dhe ekspertizë psikiatrike shumën prej 352.00-€ si dhe në emër të taksës gjyqësore shumën prej 150.00 euro, gjithsej në shumën 2332.40-€.

Nga arsyet e cekura më lartë, e duke u bazuar në nenin 143 paragraf 1 të LPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
C.nr. 600/16, datë 18.10.2023

Gjyqtari
Argzon Muçaj

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditëve, nga dita e marrjes së të njëjtit, drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.